

Aneksi A**SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS****Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1.	Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist)	Rep. Usht. nr.1010, Vau-Dejës	Shkodër	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	07.11.2025	20.11.2025

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës: “ Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist) ”, në skuadrën e shërbimëve, toga e mirëmbajtjes me shërbime, në repartin ushtarak nr.1010, Shkodër, Regjimenti i Këmbësoris së Veriut, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje D-001, kod grupi C, numër paragrafi 16, numër rendor 003 dhe specialitet LI 2390.	
2. Kodi i pozicionit: Civil, (Civil II).	
3. Reparti/Institucioni: Repartin Ushtarak nr.1010, Regjimenti i Këmbësoris së Veriut, në Forcën Tokësore.	
4. Vendi: Shkodër	
5. Paga: VKM Nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.	
6. Lloji i kontratës së punës: E pacaktuar.	
7. Data e fillimit të aplikimit: 07.11.2025	
8. Data e mbylljes së aplikimit: 20.11.2025	
9. Mënyra e aplikimit: Me dosje	
10. Dokumentat e aplikimit: - Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës mesme/në origjinal ose e noterizuar. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit nëse ka. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Raport mjekësor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.	

Dokumentacioni i aplikimit për punë të dorëzohet në sekretarinë e Forcës Tokësore, Zall-Herr, Tiranë

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- Të ketë shtetësinë shqiptare.
- Të jetë jo më pak se 18-vjeç.
- Të ketë kryer detyra si Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist), si dhe të ketë eksperiencë pune mbi 2-3 vjet.
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor (te mesëm) si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara.
- Të ketë eksperiencë pune.
- Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore.
- Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit

Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil, (C2).
- Arsimi: Të ketë kryer arsimin 12-vjeçar/mesëm.
- Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara.
- Trajnimi: Nuk është e aplikueshme.
- Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon sidomos si Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist)
- Gjuha e huaj: e pa aplikueshme
- Kërkesa të tjera specifike: Të ketë eksperiencë sidomos si Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist), të katë aftësi të mira komunikuese, preferohet të jetë me vend-banim në zonën e Shkodrës.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme.
- Niveli i çertifikatës së sigurisë: e pa aplikueshme.

Përshkrimi i punës:

“**Teknik I mesëm (Hidraulik/kaldaist)**”, në skuadrën e shërbimëve, toga e mirëmbajtjes me shërbime, në repartin ushtarak nr.1010, Shkodër, Regjimenti i Këmbësoris së Veriut, në Forcën Tokësore, kontribuon në mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik në repart, është përgjegjës për sistemin e kaldajave në repart, etj

- Të njohë të gjitha dispozitat ligjore dhe kërkesat e rregulloreve, që kanë të bëjnë me punën e tij dhe I zbaton ato me rigorozitet.
- Të njoh dokumentacionin e rrjetit hidraulik.
- Të kontrolloj çdo ditë rrjetin e brendshëm e të jashtëm hidraulik e të marrë masa përkatëse për riparimin e defekteve të konstatuara.
- Të kontrolloj çdo ditë gjendjen e pajisjeve hidrosanitare e të rrjetit ngrohës e të marrë masa për eliminimin e defekteve.
- Të administroj e të evidentoj në kartelën përkatëse të gjitha pajisjet, materialet që ka në ngarkim nga magazina dhe të objekteve.
- Të planifikoj dhe siguroj mjetet e nevojshme për punë.
- Të plotësoj dokumentacionin e nevojshëm për shkarkimin e materialeve të konsumuara.

- Të marrë të gjitha masat për furnizimin me ujë të objekteve dhe depozitave të repartit.
- Të zbatojë orarin e punës.

Përgjegjësitë: Ndjek dhe zbaton detyra të ngarkuara nga Komandanti i repartit ushtarak nr.1010.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.

Shef sektori dhe Specialist personeli për përkrahjen dhe Ankesë – kërkesat

Major Ilir Llupo